



Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor shkurtimisht

Instrumenti i Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) është një platformë unike dhe e suksesshme bashkëpunimi që i bashkon përfituesit, donatorët dhe huamarrësit për të përmirësuar harmonizimin dhe bashkëpunimin e investimeve për zhvillimin socio-ekonomik të Ballkanit Perëndimor.

Rezultatet e arritura në periudhën 2008–2019



937 km

rrugë të reja



2 m

njerëz të cilët kanë përfituar nga sistemi i furnizimit me ujë /trajtimit i ujërave të zeza



5,390

mbështeten nga "Prog. për Inovacion dhe Zhvillim të Kompanive të Ballkanit Perëndimor" (WB EDIF)



90 MW

e energjisë elektrike prodhohet nga burime të ripërtëritshme



96,000

nxënës të cilët kanë përfituar nga shkolla më të mira



Interneti me shtrirje të gjerë

zhvilluar nëpërmjet asistencës teknike

WBIF si një instrument i kombinuar

- Grante nga Instrumenti i BE-së për Ndihmën e Para-Anëtarësimin (IPA), donatorë dypalësh dhe institucione financiare pjesëmarrëse në projekt;
- Kredi nga institucionet financiare pjesëmarrëse në projekt;
- Kontributet e përdoruesve për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të infrastrukturës.

Objektivat

- Trajtimi i nevojave të shumta të infrastrukturës së Ballkanit Perëndimor;
- Ofrimi i mbështetjes për përfituesit në procesin e pranimit në BE.

Arritjet

- Pronësia përfituese e projekteve;
- Prioriteti i investimeve strategjike;
- Përmirësimi i konkurrencës dhe stimulimi i rritjes.
- Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe nderlidhjes

Portofoli i WBIF

Projektet e mbështetura	194
Vlera e parashikuar e projekteve	€20.8 mld
Grante të dhëna nga WBIF	€1.3 mld
Përdorimi optimal i kredive	€6.1 mld
Donatorët	25
Përfituesit	6

Ndërtimi i përbashkët i së ardhmes evropiane

WBIF është një iniciativë e përbashkët e Komisionit Evropian, Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Evropës (CEB), Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Bankës Evropiane të Investimeve (EIB), donatorë dypalësh dhe përfitues në Ballkanin Perëndimor, e nisur në dhjetor 2009 për të siguruar asistencë teknike dhe financiare për investime strategjike. Banka Gjermane për Zhvillimi (KfW) dhe Banka Botërore (WB) më pas iu bashkuan platformës. Në dhjetor 2018, Agjencia Franceze e Zhvillimit (AFD) u bë pjesëmarrëse në WBIF.

WBIF kombinon grante, hua dhe kontribute të përfituesve për investime në infrastrukturë në sektorët e energjisë, mjedisit, sektorin social, transportit dhe digjital, si dhe për zhvillimin e sektorit privat. Së bashku me përfituesit në Ballkanin Perëndimor, WBIF është pjesë e një partneriteti unik që përcakton përparësitë dhe paketat e ndihmës për investime strategjike dhe reformë institucionale në rajon. WBIF kontribuon në perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor duke mbështetur investime që përmirësojnë konkurrencën, rritjen, dhe plotësimin e masave të politikave, të cilat nxisin bashkëpunimin dhe ndërlidhjen në rajon.

Që prej vitit 2008, WBIF ka ndarë 1.3 miliardë euro grante për 20.8 miliardë euro investime të vlerësuara në lidhje të mira transporti, energjetike dhe rrjetet digjitale, energjinë e ripërtëritshme dhe eficiente, furnizimin me ujë dhe sistemin e menaxhimit të ujërave të zeza, mbrojtja nga përmbytja, arsimimin, qendrat e kërkimit shkencor dhe të kulturës, institucionet shëndetësore dhe gjyqësore, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm në rajon.

Partneritetet e përbashkët midis:



Në partneritet me:



Donatorët dypalësh:



Përfituesit:

